



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4885/13 prot.

07.01.2021

Gramsh, më \_\_\_/\_\_\_/2020

VENDIM

Nr. 97, datë 28.12.2020

PËR  
MIRATIMIN E LISTËS EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT  
PARAUNIVERSITAR QË FREKUENTOJNË NË SHKOLLA PROFESIONALE TË  
ARSIMIT TË MESËM PUBLIK TË CILËT PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE  
PËR PËRFITIMIN E BURSËS PËR VITIN MËSIMOR 2020-2021

Këshilli Bashkiak i mbledhur në datë 28/12/2020 mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, neni 21 pika 1 dhe 3, neni 22 si dhe VKM. nr.666 datë 10.10.2019 për “Kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet e arsimit publik, për vitin shkollor 2019-2020, pika 2.4 /b (jashtë kriterit ekonomik) për nxënësit me vendbanim të përhershëm në zonat verilindore dhe juglindore të vendit ku përfshihet Bashkia Gramsh, si dhe shkresës nr.21839 prot, datë 23.11.2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional me banim në juridiksonin e Bashkisë Gramsh, numri i bursave të miratuara është 29 (njëzet e nëntë), si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga zv/Kryetari i Bashkisë.

VENDOSI

1. Të miratojë listën emërore me **29 (njëzet e nëntë) nxënës** me 100 % B (Bursë të plotë) që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, të regjistruar në vitin e parë shkollor dhe që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës për vitin shkollor 2020-2021.

*(Lista emerore me të dhënat përkatëse, bashkëngjitur këtij projekt-vendimi si pjesë përbërëse e tij).*

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI I KËSH. BASHKIAK  
BASHKIAK

XHULIA GJINI

Konceptoi: Xh.Gjini  
Pranoi: G.Lena  
Miratoi: G.Lena  
Dosja nr:  
Afati i ruajtjes: RHK

KRYETARI I KËSH.

GRETA LENA

